



A.nr. 363/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: dhe Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtare, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr. 363/ 2026, të datës 27.03.2026, të parashtruar nga ankuesi A.G, kundër organit të punësimit/ Agjencia e Kosovës për Forenzikë, në çështjen juridike “ masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 21.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr. 363/ 2026, e datës 27.03.2026, e parashtruar nga ankuesi A.G.

A r s y e t i m

Ankuesi A.G, (me tej referuar vetëm ankuesi), më datë 27.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A. nr. 363/2026 kundër vendimit AFK/2015-323 i datës 28.07.2015, lidhur me emërim e z. B.K për pozitën Drejtor i Departamentit për Teknologji Informative Forenzik dhe vendimit AFK/2019-170 i datës 19.07.2019 lidhur me emërim B.K për pozitën Drejtor i Departamentit për Teknologji Informative Forenzik, duke pretenduar se nga data 19.07.2019 deri në shtator të viti 2025, B.K ka vazhduar të ushtrojë detyrën si ushtrues i detyrës Drejtor i Departamentit për IT. Forenzikë, me tej ankuesi ka pretenduar se ushtruesi i detyrës në një pozitë drejtuese në cilësinë të ushtruesit është i përkohshëm dhe i kufizuar në kohë dhe se pas përfundimit të mandatit të detyrës ose në rast të mos vazhdimit të mandatit të emëruarit në kategorinë e mesme drejtuese apo të ulët drejtuese sistemohen nga njësia përgjegjëse në një pozitë të lirë të kategorisë profesionale e që në rastin konkret duhet të kthehet në pozitën e ekspertit forenzikës e jo në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit me tej ankuesi ka pretenduar që të shqyrtohet ligjshmëria e vendimeve të kontestuar të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë për emërimin e B.K i, në pozitën ‘Udhëheqëse i Divizionit për Forenzikë Multimediale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 02.04.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Agjencia e Kosovës për Forenzikë, ndërsa kjo e fundit, më datë 14.04.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.nr.363/2026 të datës 27.03.2026, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopje e letërnjoftimit për ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.04.2026, dërguar nga R.K, për N.B; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 363/2026, e datës 14.04.2026; Vendimi me numër protokollit Nr. AFK-043/2026, i datës 18.03.2026, i nxjerr nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë; Vendimi me numër protokollit Nr. AFK-136/2025, i datës 17.09.2025, i nxjerr nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë; Vendimi me numër protokollit Nr. AFK/2015-353, i datës 28.07.2015, i nxjerr nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë; Vendimi me numër protokollit Nr. AFK/2019-170, i datës 17.09.2019, i nxjerr nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë; Diplomë me numër protokollit 765/11, e datës 20.08.2011, për B.K, e lëshuar nga Kolegji Riinvest; Përshkimi i detyrave të punës Udhëheqëses i Divizionit për Ekspertizë të Forenzikës Multimediale.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit A.G, është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, ndërsa sipas vendimit për Transferimin e Përhershëm me numër protokollit AFK/2024-014 të datës 11.02.2024, mbanë pozitën “ Ekspert Forenzik për Daktiloskopi dhe Traseologji”, në Divizionin e Daktiloskopisë dhe Traseologjisë.

Tutje, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, sipas vendimit me numër protokollit Nr. AKF -136/2025, të datës 17.09.2025 ka shfuqizuar vendimin me numër protokollit AFK/2019, të datës 17.09.2025, për B.K i caktuar ushtrues i detyrës Drejtor i Departamentit për Teknologji Informativ Forenzikë, duke e kthyer B.K në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Ekspertizë të Forenzikës Multimediale/ Departamenti i Forenzikës dhe Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.

Ankuesi A.G, me datë 27.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore sikurse janë shënuar më lartë në këtë arsyetim.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës. Kolegji i Këshillit ju referua nenit 27, paragrafi 3 Ligjit nr. 08/1-197 për Zyrarët Publik, ku përcaktohet shprehimisht se; 3. *Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e*

punës në shërbimin civil, si dhe si dhe nenin 127,, paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se: “1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ...*” rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke marrë parasysh faktin së ankuesit nuk i është cenuar asnjë e drejtë nga marrëdhënia e punës, si dhe ankuesi veprimin e fundit e ka ndërmarr kundër vendimit me numër protokollit Nr. AKF -136/2025, të datës 17.09.2025 do të thotë është ankur kundër këtij vendimi në KPMSHCK me datë 27.03.2026, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa A.nr.363/2026 e datës 27.03.2026, është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat e nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Andaj, në këtë kuptim, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e parashtruar jashtë afatit ligjor nuk është e pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ndërlidhur me ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshilli, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesi ka qenë i obliguar që ankesën ta parashtronte në pajtim me Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji nr. 08/1-197 për Zyrtarët Publik, në afatin prej (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ, prandaj Kolegji i Këshillit nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore tjera të ankuesit, sepse ankesën e ka parashtruar jashtë afatit ligjor për parashtrimin e ankesës.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. nr. 363/2026

Rushit Kajtazi

Eshref Shabani

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet;

- Ankuesit A.G;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.